



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr.4, datë 14.06.2024

**“Për mbledhjen e kandidaturave për krijimin e Sekretariatit Teknik pranë Komisionit të
Posaçëm Parlamentar”**

Bazuar në nenin 24 e vijues të Regullores së Kuvendit dhe në pikën X të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të kryetarit, Komisioni i Posaçëm

VENDOSI:

1. T’u kërkojë Kuvendit, Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministrisë së Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore që të mundësojnë që këshilltarë/specialistë pranë stafeve të tyre, të përshtatshëm për qëllimet e objektin e punës së këtij komisioni të mund të bëhen pjesë e Sekretariatit Teknik, i cili do të funksionojë pranë Komisionit të Posaçëm.
2. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për t’u komunikuar institucioneve përkatëse të mësipërme vendimin e Kuvendit, objektin e punës së komisionit, organizimin dhe kohën e veprimtarisë së tij, si dhe numrin kriteret e cilësitë e domosdoshme që duhet të përmbushin specialistët për t’u përfshirë në Sekretariatin Teknik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FATMIR XHAFAJ

Miratuar me 14.06.2024